

V E N D I M
Nr. 216, datë 5.5.2000

**PËR SHPËRBLIMIN E CILËSISË SË LARTË SPORTIVE TË PESHËNGRITËSAVE
SHQIPTARË DHE PËR PËRGATITJEN E TYRE PËR LOJËRAT OLIMPIKE “SIDNEY
2000”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohet shuma prej 6 milionë lekësh, për shpërblimin e cilësisë së lartë sportive, të arritur nga sportistët tanë në ngjarjet e fundit, botërore e europiane, të peshëngritjes dhe për përgatitjen e tyre për Lojërat Olimpike “Sidney 2000”.

2. Shuma e mësipërme të ndahet si vijon:

a) Peshëngritësi Ilirjan Suli, për rezultatet e larta të arritura në Kampionatin European të peshëngritjes, ku u shpall nënkampion i Europës, shpërblehet me 3 milionë lekë.

b) Peshëngritësi Ilir Kafarani, për rezultatet e larta të arritura në Kampionatin Botëror të peshëngritjes dhe për paraqitjen dinjitoze në Kampionatin European shpërblehet me 2 milionë lekë.

c) Pavarësisht nga të ardhurat e tjera, mbështetja financiare e këtyre peshëngritësve, deri në prag të Lojërave Olimpike “Sidney 2000”, të jetë 100 000 lekë në muaj.

Ç) shuma prej 200 000 lekësh të përdoret për sistemin e veçantë të peshëngritësve, për trajtimin mjekësor, fizioterapeutik dhe vitaminoz dhe për nevoja të tjera, me interes sportiv në dobi të tyre.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta